

## **SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË, PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL PËR KATEGORINË E MESME DREJTUESE**

1. Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe Urdhrit nr.148 dhe 149, datë 15.09.2021 të Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për “Hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall Procedurën e pranimit në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues si më poshtë;
- **1 (një) - Këshilltarë në Njësinë e Mbështetjes Komisioneve, në Departamentin e Shërbimeve Ligjore, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë – kategoria: II-b**
- **1 (një) - Këshilltarë - Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore, Departamenti i Shërbimeve Ligjore, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë - kategoria-II-b**

*Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil.*

**PËR TË TRE PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË, PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL ) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

**27/09/2021**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

**LËVIZJE PARALELE**

---

**04/10/2021**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

**NGRITJE NË DETYRË**

**04/10/2021**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

---

**PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin/et si më sipër është:

- Ruajtja dhe përditësimi i njohurive profesionale rreth kuadrit ligjor dhe zhvillimeve jurisprudenciale relevante për punën e Këshillit;
- Kërkimi ligjor dhe hartimi i projekt akteve individuale dhe nënligjore (*dhe relacionet përkatëse*) të cilat shqyrtohen dhe miratohen në mbledhjet plenare të Këshillit ose në komisione, në ushtrim të kompetencave të Këshillit;
- Hartimi i opinioneve ligjore, politikave, deklaratave e qëndrimeve për llogari ose në emër të Këshillit ose komisioneve të tij (*Këshillit*) si dhe kontributi për hartimin e ligjeve në fushën e veprimtarisë së Këshillit duke mbajtur gjithnjë parasysh nevojën për përafrimin me legjislacionin europian.
- Kërkimi i informacionit, hartimi i dokumentacionit dhe këshillimi mbi funksionet e komisioneve të përhershme të Këshillit.
- Konceptimi dhe përpilimi i përgjigjeve zyrtare të çdo shkrese administrative që korrespondon me fushën e veprimtarisë së komisionit përkatës.

## 1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori II-b;
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të paktën 7 vjet eksperiencë pune në dhënien e këshillimit ligjor dhe shërbimeve përkatëse në administratës shtetërore dhe në kompani të konsulencës, projekteve në fushën e këshillimit ligjor, ofrimit të shërbimeve publike, ose 1 vit eksperiencë pune në institucionet e sistemit të drejtësisë.
- Njohuri të mira të gjuhës angleze.

### 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass
- Fotokopje të diplomës të noterizuar (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, rruga “Ana Komnena”, Godina “Poli i Drejtësisë”, ish fusha aviacionit, Tiranë.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës:  
**27.09.2021**

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **28.09.2021**, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Kompetencat e institucioneve të ndryshme dhe vendi që zenë ato në strukturën e përgjithshme qeveritare;
- Legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë (ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Ligj Nr. 96/2016 Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve);
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- Kodin e Procedurave Administrative, legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë (ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Ligj Nr. 96/2016 Për Statusin E Gjyqtarëve Dhe Prokurorëve);
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- Kodin e Procedurave Administrative

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës; b - Eksperiencën e tyre të mëparshme; c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga KLP, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## **2. NGRITJA NE DETYRE**

**Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke filluar nga data 14/10/2021.**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a. Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, I një kategorie më të ulët III-a ose III-a/1;
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b. Të paktën 7 vjet eksperiencë pune në dhënien e këshillimit ligjor dhe shërbimeve përkatëse në administratës shtetërore dhe në kompani të konsulencës, projekteve në fushën e këshillimit ligjor, ofrimit të shërbimeve publike, ose 1 vit eksperiencë pune në institucionet e sistemit të drejtësisë.

- c. Njohuri të mira të gjuhës angleze.

## 2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

### Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- g. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass
- h. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- i. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- j. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- k. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- l. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- m. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- n. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- o. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Rr. Ana Komnena, ish Fusha Aviacioni, Tiranë.

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të bëhet brenda datës: **04.10.2021****

## 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **14.10.2021** Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga KLP, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## 2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

### Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Kompetencat e institucioneve të ndryshme dhe vendi që zenë ato në strukturën e përgjithshme qeveritare;
- Legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë (ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Ligj Nr. 96/2016 Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve);
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);

- Kodin e Procedurave Administrative, legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë (ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Ligj Nr. 96/2016 Për Statusin E Gjyqtarëve Dhe Prokurorëve);
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- Kodin e Procedurave Administrative

#### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me;**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

#### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- I. Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- II. Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- III. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

## **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLP do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për fazat e mëtejshme të kësaj

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;

## **3. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke filluar nga data 14.10.2021.**

### **3.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje; f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të paktën 7 vjet eksperiencë pune në dhënien e këshillimit ligjor dhe shërbimeve përkatëse në administratës shtetërore dhe në kompani të konsulencës, projekteve në fushën e këshillimit ligjor, ofrimit të shërbimeve publike, ose 1 vit eksperiencë pune në institucionet e sistemit të drejtësisë.
- c- Njohuri të mira të gjuhës angleze.

### **3.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass
- b. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Rr. Ana Komnena, ish Fusha Aviacioni, Tiranë.

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit nga jashtë duhet të bëhet brenda datës **04.10.2021****

### **3.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **14.10.2021**, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në shërbimin civil, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e veçanta për procedurën e pranimit nga jashtë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga KLP, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

### **3.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Kompetencat e institucioneve të ndryshme dhe vendi që zenë ato në strukturën e përgjithshme qeveritare;
- Legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë (ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Ligj Nr. 96/2016 Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve);
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- Kodin e Procedurave Administrative, legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë (ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Ligj Nr. 96/2016 Për Statusin E Gjyqtarëve Dhe Prokurorëve);
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- Kodin e Procedurave Administrative

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **3.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**



a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;

b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë; c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

### **3.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimin nga jashtë, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;